

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Fllanza Kadiu dhe Tonka Berishaj anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Shaqë Curri, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit D.H, nga V., për shkak të veprave penale: Trafikim me njerëz nga neni 171 par. 1 të KPK, Blerja, posedimi , shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm parashikuar me nenin 229 par. 2 të KPK, Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm parashikuar me nenin 375 par. 2 të KPRK-së dhe Lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par. 1 lidhur me par. 4 nënparagrafi 1 pika 1 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe asaj të mbrojtësit të akuzuarit av. Kapllan Baruti të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.16/13 datë 02.12.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 23. Prill 2015 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.16/13 datë 02.12.2014, *anulohet* dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë për rigjykim.

II. Aktgjykimi në pjesën refuzuese ngel i pashqyrtuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit ngel jolëndore.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.16/13 datë 02.12.2014 i akuzuari D.H. në bazë të nenit 364 të KPP është liruar nga akuza për veprat penale Trafikim me njerëz nga neni 171 par. 1 të KPK, Blerja, posedimi , shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par. 2 të KPK, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm parashikuar me nenin 375 par. 2 të KPRK-së, ndërsa në bazë të nenit 365 të KPP është shpallë fajtor për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 1 lidhur me par. 4 nënparagrafi 1 pika 1 të KPK, dhe në bazë të nenit 363 të KPP është refuzuar akuza për veprën

penale Mbajtja në pronësi ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK. Për veprën penale për të cilën është shpall fajtor (pika V e dispozitivit, është gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 23.10.2012 e gjerë më datë 31.12.2012 dhe prej datës 18.01.2013 e gjerë më datë 21.05.2013 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 31.12.2012 gjerë më 18.01.2013 dhe nga data 21.05.2013 e gjerë më 26.07.”2014”. Në bazë të nenit 60 të KPK-së i është shqiptuar dënimi plotësues, marrja e sendit - pistoleta e markës MICROSD, me numër serik IY 039F000938 e ngjyrës së zezë me dorëz të ngjyrës të bronzet. Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur, ndërsa i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor është obliguar të paguaj shumën prej 100€.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa kanë ushtruar:

- Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për pjesën liruese për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, ndërsa për pjesën gjyqësore për vendimin për dënim me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

- mbrojtësi i të akuzuarit K.B, avokat nga ..., vetëm për shkak të vendimit për dënim me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me kohëzgjatje në përpjesëtim me kohën e kaluar në paraburgim e arrest shtëpiak ose t’i shqiptohet dënim më i butë.

Për seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP, janë njoftuar palët. Në seancë mori pjesë Prokurori i Apelit Idain Ismaili dhe mbrojtësi i të akuzuarit avokati K.B, i cili njoftoi se i akuzuari edhe pse i njoftuar nuk do të merr pjesë në seancë. Prokurori i Apelit në tersi ngeli pranë parashtrësës PPA/L.nr.60/15 datë 05.02.2015 duke mbështetur ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë duke propozuar që ankesa të aprovohet ndërsa ajo e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar. Mbrojtësi i të akuzuarit pasi që sqaroi disa pretendime ankimore të ankesës me shkrim propozoi që ankesa e të aprovohet ndërsa ajo e Prokurorit të refuzohet.

Gjykata Apelit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko- penale, vlerësoi aktgjykimin e kundërshtuar bashkë me pretendimet ankimore dhe konform nenit 394 të KPP gjeti se:

- ankesa e Prokurorit është e bazuar ndërsa ajo e mbrojtësit të akuzuarit tani për tani është jolëndore.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i kundërshtuar nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 370 par.6 të KPP sipas të cilit gjykata në arsyetim të aktgjykimit paraqet arsye për çdo pikë të aktgjykimit, dhe par.7 të të njëjtit nen, sipas të cilit gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, arsyet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes se çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.

Kështu, në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë për pjesën gjyquese gjykata vetëm ka theksuar se: “ *gjatë procedurës së provave, gjykata ka dëgjuar dëshmitarët Z.F., të dëmtuarën T.H., ka lexuar provat materiale...Të gjitha këto prova gjykata me ndërgjegje i vlerësoi një nga një dhe në tersi në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, në vështrim të nenit 361 vërtetoi këtë gjendje faktike: se më 19.10.2012 në vendin si në pikën 2 të dispozitivit personit tjetër me të cilin është në marrëdhënie familjare i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor të dëmtuarës T.H., në at mënyrë që pas një mosmarrëveshje pasi që e dëmtuara ka kërkuar të blej gjëra ushqimore, i pandehuri me shuplaka të dorës e godet në fytyrë dhe pjesë tjera të trupit të cilës i shkaktonte hematoma(mavijosje) dhe gërvishtje që janë lëndime të lehta trupore. Gjykata pasi që i ka vlerësuar të gjitha provat, ka vërtetuar se nuk është kontestues fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale nga pika e 5 e aktakuzës për të cilën ngarkohet. Më tutje në kryerreshtin e katërt të faqes 6 të aktgjykimit të kundërshtuar konstaton “ Në bazë të gjitha këtyre provave gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit D.H. ekzistojnë të gjitha elemente e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 lidhur me par.4 nënparagrafi 1 pika 1 të KP. Ndërsa për pjesën liruese konstaton, “...kurse lirohet nga akuza për veprat penale Trafikim me njerëz nga neni 171 par. 1 të KPK, Blerja, posedimi , shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par. 2 të KPK, dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm parashikuar me nenin 375 par. 2 të KPRK sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer këto vepra penale...” Mëtej në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë arsyeton vendimin për dënim.*

Nga kjo del se gjykata e shkallës së parë si për pjesën liruese të aktgjykimit ashtu edhe për pjesën dënuese të aktgjykimit vetëm ka cekur emrat e dëshmitarëve dhe përshkruar provat materiale por duke mos dhënë kurrfarë analize të provave lidhur me këtë çështje juridiko penale, si dhe të jep arsye përkritazi me vërtetimin e ekzistimit të veprës penale për të cilën u shpall fajtor respektivisht mos vërtetimin e veprave penale për të cilat u lirua.

Mangësitë dhe kundërthëniet e sipër cekura jo vetëm që paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPP, por janë ngushtë të ndërlidhura me bazën ankimore vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike që e vejnë në dyshim edhe aplikimin e drejtë të ligjit penal.

Prandaj, nga arsyet e lartcekura konkludimi i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të aprovohet si i drejtë dhe i ligjshëm, kështu që është dashtë që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t’i kthehet për rigjykim.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e sipër cekura t’i evitojë shkeljet e theksuara më lart, në pajtim me nenin 361 të KPP edhe një herë t’i vlerësojë të gjitha provat e propozuara një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, dhe t’i shqyrtojë edhe një herë të gjitha rrethanat e çështjes, e më pas të merr vendim të drejtë në këtë çështje penalo-juridike e duke pas parasysh edhe pretendimet që dalin nga ankesat.

Nga çka u tha më lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 402 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR 55/15, datë 23. Prill 2015

Procesmbajtësi,

Shaqë Curri _____

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi _____

Anëtarët e kolegjit:

1. Fllanza Kadiu _____

2. Tonka Berishaj _____

